



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1253/prot.

Tiranë, më 30.06.2020

VENDIM

Nr. 33, datë 30.06.2020

PËR

**MIRATIMIN E PAGESËS FINANCIARE PËR KOMISIONET E PËRHERSHME  
TË DHËNIES SË GRADËS “DOKTOR” DHE TË PROMOVIMIT TË TITUJVE  
AKADEMIK NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË**

Bazuar në pikën “c” të nenit 3, pikës “ç” të nenit 4, nenet 36, 49, 108 të Ligjit Nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenit, 33, 35, 49, 51 të statutit të UMT-së, pika 18 e VKM-së nr.329, datë 12.04.2017 “Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik”, Vendimit nr.15, datë 17.02.2020 “Për krijimin e komisionit të përherëshëm për promovimin e personelit akademik në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë” të Senatit Akademik, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 29.06.2020, pasi mori në shqyrtim Vendimin nr.24, datë 17.03.2020 “Për miratimin e pagesës financiare për komisionet e përherëshme të dhënies së gradës “doktor” dhe të promovimit të titujve akademik në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë” dhe u njoh me materialin nr.1253 prot, datë 10.06.2020 “Mbi vendimin nr.24, datë 17.03.2020 të Senatit Akademik” të Administratorit të UMT-së, pas diskutimeve për këtë pikë,

VENDOSI:

1. Masa e shpërblimit për komisioneve të përherëshme të dhënies së gradës “Doktor” dhe të promovimit të titujve akademik në UMT-ë të jetë si më poshtë:
  - Kryetarët e komisioneve 18,000 (tetëmbëdhjetëmijë) lekë në muaj.
  - Anëtarët e komisioneve 15,000 (pesëmbëdhjetëmijë) lekë në muaj.
  -
2. Shpenzimet për kryerjen e pagesës së antarëve në përbërje të komisioneve vërtetohen kundrejt dokumentit të pjesëmarrjes në mbledhje.
3. Një anëtar nuk mund të bëjë pjesë më shumë se në dy komisione.
4. Fondet e nevojshme për mbulimin e këtyre pagesave do të përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2020.



5. Ngarkohet për zbatimin dhe publikimin në website të këtij vendimi Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

**KRYETARI**

**Florian TOTI**

